



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353-40936/20

Datë: 06.10.2020

Prizren

Në bazë të nenit 6, 7, 13, 14, 15, 16, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje (Gazeta Zyrtare Nr. 14, 20.Gusht 2018) dhe Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura **Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor – Sektori i Legalizimit me Datë : 06.10.2020** nxjerr:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E CERTIFIKATËS SË LEGALIZIMIT

I. Ky Vendim lëshohet për aplikuesin dhe ndërtimin sipas kushteve të përcaktuara në tabelat e mëposhtme:

1. Aplikuesi për legalizim		A është aplikuesi përfaqësues i autorizuar? Jo <input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/>	
Emri:	Ali Aliu	Nr. I ID:	
Adresa:	Rr “ Çanakale “ Prizren		
Telefoni:		Emaili	Ark.aliu@gmail.com

2. Ndërtimi për të cilin lëshohet ky vendim:			
Adresa e ndërtimit (ose përshkrimi i lokacionit):	Rr “ Çanakale “ Prizren		
Emri i pronarit të regjistruar të parcelës:	Mitat Vorfaj	Nr. i ID:	
Emri i pronarit të ndërtimit:	Mitat Vorfaj	Nr. i ID:	
Zona Kadastrale:	Prizren	Nr. i Parcelës Kadastrale:	6915-7
Koordinatat e GPS:	Y =7476842,105 m, X= 4674712,621 m,		



Sipërfaqja e parcelës ndërtimore:	800 m ²
-----------------------------------	--------------------

3. Informatat për ndërtimin:			
Kategoria I dhe shtëpitë e kategorisë II <input checked="" type="checkbox"/>			
Shtëpi <input checked="" type="checkbox"/>	Shtëpi me afarizëm/komerciale (banim mbi 50%) <input type="checkbox"/>		
Garazh në shërbim të shtëpisë <input type="checkbox"/>	Objekt bujqësor (deri 600m ²) <input type="checkbox"/>	Depo e kategorisë I <input type="checkbox"/>	
Tjetër:			
Kategoria II (nuk përfshihen shtëpitë) <input type="checkbox"/>			
Banim me shumë njësi <input type="checkbox"/>	Konvikte apo ngjashëm <input type="checkbox"/>	Hotele apo ngjashëm <input type="checkbox"/>	
Afarizëm dhe administratë <input type="checkbox"/>	Industri, depo <input type="checkbox"/>	Art, kulturë, argëtim <input type="checkbox"/>	Arsim, shkencë <input type="checkbox"/>
Shëndetësi <input type="checkbox"/>	Sport, rekreacion <input type="checkbox"/>	Bujqësi <input type="checkbox"/>	
Tjetër:			
Ndërtim i përfunduar pa leje ndërtimi <input checked="" type="checkbox"/>		Tejkalimi i lejes së ndërtimit <input type="checkbox"/>	
Ndërtim i përfunduar me leje legalizimi <input type="checkbox"/>		Ndërhyrje pa leje në ndërtesë me leje <input type="checkbox"/>	
Sipërfaqja bruto e ndërtimit:	401.80 m ²	Numri i kateve:	B+ P + 1

II. Përmbledhje e gjetjeve faktike

Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor – Sektori i Legalizimit i ka shqyrtuar të gjitha provat e paraqitura në këtë rast dhe ka trajtuar lëndën me Nr: 04-353-40936/20 dhe dokumentet e dorëzuara sipas kërkesave të Nenit 4 (Procedurat e Aplikimit për Certifikatë të Legalizimit) të Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr.06/2-19, është konstatuar se Lënda ka plotësuar të gjitha dokumentacionet e nevojshme duke evidentuar faktet e mëposhtme:

Mitat Vorfaq Pronar i Objektivit – Shtëpisë i lindur me datën : 14.06.1969 me Nr. Personal dhe me banim në Louisenstrasse 138.61348 Bad Homburg me datën 22.qershor 2020 përmes Noterit Dr. Steffen Alexander Hutzel të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyesja e autorizuar gjyqësore Prof.Erlinda Luma - ka noterizuar z. Ali Aliu i lindur 18.05.1992 nga Dragashi me Nr. Personal **që të më përfaqësojë pranë Komunes së Prizrenit t'i udhëheqë të gjitha procedurat e nevojshme juridike – administrative dhe procedurale për Legalizimin e Shtëpisë që është e ndërtuar në ngastrën Kadastrale me Nr. P-71813068-06915-7 me sipërfaqe prej 800 m² ZK Prizren dhe t'i nënshkruaj të gjitha dokumentacionet në emrin tim duke paraqitur para organeve kompetente komunale në Prizren.**

1. Formulari standard i aplikimit për certifikatë të legalizimit për kategorin I dhe Shtëpi të kategorisë II (mbi 450 m²), është formulari që aplikuesi ka plotësuar dhe dorëzuar kërkesën për marrjen e certifikatës së legalizimit dhe në këtë formular gjenden të dhënat personale të aplikuesit të kërkesës, informatat rreth pronarit të ndërtimit dhe detajet e ndërtimit, dhe pas shqyrtimit të Shtojcës 1. është vazhduar me shqyrtimet e dokumentacioneve tjera të kësaj Lënde.

2. Deklarata e Pronarit të ndërtimit pa leje e cila është bërë me datën 19.06.2020 në Prizren ndërmjet te autorizuarit te pronarit të ndërtimit Ali Aliu dhe zyrtarit kompetent Agron Kryeziu që ka pranuar deklaratën dhe ka shqyrtuar te gjitha dokumentacionet e kësaj lënde dhe ka vërtetuar se lënda posedonë : Certifikatën e pronës me numrin e njësis kadastrale P- 71813068-06915-7 ZK Prizren, e datës 28.05.2020, ku ëshë vërtetuar Mitat Vorfaj është pronar i ngastrës P- 71813068-06915-7, kopjen e planit P- 71813068-06915-7 ZK Prizren, e datës 28.05.2020, kopjen e leternjofimit të pronarit të ndërtimit, fotot e objektit në formatin A4 në origjinal, 3 kopje fizike plus 1 CD dixhitale, situacioni, raporti i instrumentit, matjet Gjeodezike nga gjeodetja e licencuar Hatixhe Hoxha me Nr. e Lëndes 045\2020, Nr. e Licencës 200 e datës 08.06.2020 dhe kopjen e letërnjofimit të gjeodetit.
3. Shqyrtimi i aplikacioneve për të gjitha kategorit - që nënkuptonë që pas plotësimit të kësaj Shtojce është vërtetuar dhe konstatuar se aplikuesi i kërkesës, pronari i objektit i ka përbushur dokumentacionet e nevojshme për të vazhduar më tutje me shtojcën 8.
4. Shtojcën 8 - me anë të kësaj shtojce, aplikuesi me datën : 17.09.2020 është njoftuar ta kryej pagesën e taksës apo tarifës mbrenda 15 ditëve nga Data e pranimit, për lëshimin e Certifikatës së Legalizimit.
5. Aplikuesi mbrenda afatit kohor me datë: 17.09.2020 ka sjellur dëshmin e kryerjes së pagesës së taksës, me sipërfaqe të objektit **401.80 m²** , taksa për metër katror është 1.00 €, që i bie në Total **401.80 €**.

III. Baza ligjore

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar dhe kushteve ekzistuese të ndërtimit, **Komuna e Prizrenit Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor – Sektori i Legalizimit me Lëndën me Nr.04-353-40936 të Datës : 29.05.2020** konstaton se ndërtimi i përshkruar më lartë i plotëson të gjitha kriteret për legalizim në pajtim me nenin 6, 7, 13, 14, 15, 16, 18 dhe 19 të Ligjit 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.

IV. Vendimi

Në bazë të arsyetimit si më lartë, ky ndërtim **LEGALIZOHET** në pajtim me kushtet e Ligjit 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa leje.

1. Kjo certifikatë e legalizimit vërteton se ndërtimi pa leje plotëson kërkesat për legalizim sipas Ligjit 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe lejon shfrytëzimin e ndërtimit.
2. Ky Vendim për legalizim të ndërtimit pa leje, lëshohet vetëm për ndërtimin aktual. Çfarëdo pune ndërtimore shtesë në ndërtimin e legalizuar duhet të jetë në përputhje me ligjin në fuqi për ndërtim, ligjin në fuqi për planifikim hapësinor, planet hapësinore përkatëse dhe ligjet tjera në fuqi.

3. Për qëllim të regjistrimit të ndërtimit të legalizuar në kadastër, certifikata e legalizimit është e barazvlefshme me certifikatën e përdorimit.
4. Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në komunë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij Vendimi, duke zbatuar procedurën e Udhëzimit Administrativ të MMPH-së për procedurat e ankesës për vendimet mbi trajtimin e ndërtimeve pa leje në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:


1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Inspektoratit të Komunës;
3. Arkivës së Komunës;
4. Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadaster ;

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

NR. 04-353-40936/20

DT : 06.10.2020

Bashkëpunëtori Profesional :



Ylber Gashi – Inxh.Dip.Ark.